

Përmbledhje

KPA SHQYRTON ANKIMIN E KOMISIONERIT PUBLIK, NDAJ VENDIMIT TË KPK-SË QË KONFIRMOI NË DETYRË ZNJ. MIRANDA ANDONI, GJYQTARE PRANË GJYKATËS SË APELIT GJIROKASTËR

RAPORTIM PARAPRAK I SEANCËS DËGJIMORE DATË 13/12/2022 PRANË KPA:

Komisioneri Publik kërkoi riçeljen e hetimit gjyqësor për dy kriteret e rivlerësimit: Mbi kriterin e pasurisë dhe mbi kriterin e aftësive profesionale.

Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi shkaqet e ankimit të KP si të pabazuara në prova dhe ligj, ndërkohë që kërkoi depozitimin e provave të reja për të mbështetur aftësinë financiare.

Me vendim të ndërmjetëm u vendos riçelja e hetimit gjyqësor dhe administrimi i provave të reja, të depozituara nga ana e subjektit.

X Seanca gjyqësore u monitorua nga vëzhguesi i KShH-së, nëpërmjet monitorit audio-vizual, të vendosur në ambientet e jashtme të sallës së gjykimit.



KPA shqyrton ankimin e Komisionerit Publik, ndaj vendimit të KPK-së që konfirmoi në detyrë znj. Miranda Andoni, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë

Më datë 13.12.2022, ora 10:00, në seancë gjyqësore publike, Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) shqyrtoi ankimin e depozituar nga ana e Komisionerit Publik, ndaj vendimit të KPK, nëpërmjet të cilit ishte vendosur konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit znj. Miranda Andoni.

Seanca gjyqësore publike u monitorua nga vëzhguesi i KShH-së, nëpërmjet monitorit audio-vizual të vendosur në ambientet e jashtme të sallës së gjykimit. Në nëntor 2022, KShH i është drejtuar KPA-së, nëpërmjet shkresës zyrtare, duke kërkuar rishikimin e Rregullores së Brendshme për përcaktimin e masave kufizuese, në raport me qasjen lehtësuese sociale të rekomanduar nga Komiteti Teknik i Ekspertëve. Në vlerësimin e KShH, transmetimi live i seancave publike të KPA-së për personat e interesuar nuk garanton të njëjtin nivel aksesit dhe rrjedhimisht edhe kuptueshmëri të mbarëvajtjes së procesit dhe vëzhgimit të sjelljes së secilës palë në seancë, si në rastet kur publiku është prezent fizikisht në sallë.

Trupa gjykuese e përbërë nga znj.Natasha Mulaj (Kryesuese), z.Sokol Çomo (Relator), znj.Ina Rama (Anëtare), znj.Albana Shtylla (Anëtare) dhe znj.Mimoza Tasi anëtarë(Anëtare), u asistua nga vëzhguesja ndërkombëtare znj. Elka Ermenkova. Në kundërshtim me nenin 464 K.Pr.C., u vërejt se në çelje të seancës gjyqësore, relatori nuk relatoi çështjen.Gjatë seancës gjyqësore, u vërejt se subjekti kishte zgjedhur të përfaqësohej personalisht dhe jo nga ana e një mbrojtësi ligjor. Ai nuk paraqiti kërkesa paraprake apo procedurale në lidhje me trupën gjykuese.

Përfaqësuesja e Komisionerit Publik znj. Irena Nino dhe subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e relatuarat prej tyre, i qëndruan shkaqeve të ankimit dhe kundër-ankimit të depozituara me shkrim, respektivisht KP kërkoi riçeljen e hetimit gjyqësor për dy kriteret e rivlerësimit: në kushtet kur për kriterin e pasurisë subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për vitet 2008-2016, konform nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ndërkohë për kriterin e aftësive profesionale konstatohen mangësi të përsëritura, zvarritje dhe tejkalim të afateve ligjore në gjykimin e disa çështjeve gjyqësore në kuptim të nenit E, pika 5 të aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi në tërësi shkaqet e ankimit të KP si të pabazuara në prova dhe ligj, ndërkohë që kërkoi depozitim të provave të reja për të mbështetur aftësinë financiare.

Rezulton se palët ndërgjyqëse janë njohur me dosjen gjyqësore, provat dhe parashtrimet e depozituara, konform nenit 36 të ligjit nr. 49/2012. Sipas neneve F, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe 45 të ligjit 84/2016, me vendim të ndërmjetëm u vendos riçelja e hetimit gjyqësor dhe administrimi i provave të reja, të depozituara nga ana e subjektit.

Në kuptim të nenit 302 të Kodit të Procedurës Civile, KPA përfundoi hetimin gjyqësor dhe ftoi palët për parashtrimin e pretendimeve të tyre përfundimtare rreth çështjes në gjykim,